

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **MINISTRIA E SHËNDETËSISË**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **206-23-14371-5-1-1**

Sa i përket tenderit për **“Vazhdim i Ndërtimit - Qendra e Mjekësisë Emergjente ne QKUK”**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	ADA CONSULTING GROUP SH.P.K.
NUI	810794215
Adresa	ARBËRI NORA E HOTIT,BLL.C2-10,OBJ."B"H1-4/2
Vendi	PRISHTINË
Kodi postar	-
Numri Telefonit	049 181 610
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Fatos Hajraj
Adresa elektronike	fatosi164@gmail.com
Data e parashtrimit të ankesës	26.04.2024

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit	Hajer Salihu
Adresa e plotë	Rr.Fehmi Agani Hy, nr.154 Kati 1 nr.8 10000 Prishtine
Numri i Telefonit	+383 44 100 002
Numri i faks-it	
Adresa elektronike	avokat.hajzer.salihu@gmail.com

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

“Vazhdim i Ndërtimit - Qendra e Mjekësisë Emergjente ne QKUK”

Lloji i kontratës: Kontratë e Punëve

Lloji i procedurës së prokurimit: Procedure e HAPUR

Klasifikimi sipas vlerës: Vlerë e MADHE, 22,513,201.67 Euro

Kriteri i dhënies së kontratës: Tenderi i ekonomikisht më i favorshëm

- **Cmimi më i ulët : 90%**
- **Garancioni i Punimeve (min 2 vite): 10%**

Publikim i Njoftimi për kontratë: 07.01.2024

Data e hapjes së tenderëve: 27.02.2024, 14:00:00, pas shtyrjes se afati nga AK.

Data e ngarkimit të “B58-Njoftim mbi vendimin e Autoriteti” kontraktues” dhe Letrat Standarde 02.04.2024

Kërkesa për Rishqyrtim 07.04.2024 është dorëzuar Kërkesa per Rishqyrtim nga grupi i operatorëve ekonomik.

Pezullimi i aktivitetit të prokurimit: 08.04.2024 është bërë pezullimi i aktivitetit të prokurimit nga autoriteti kontraktues.

Vendimi i Autoritetit Kontraktues:16.04.2024 kemi pranuar vendimin e autoritetit kontraktues, ndaj Kerkese per rishqyrtim.

Autoriteti kontraktues gjate ushtrimit të këtij aktiviteti të prokurimit ka bërë edhe dy korrigjime në dosje e tenderit dhe njoftimin per kontrate si dhe Sqarime shtesë për operatorët ekonomik përmes ngarkimit dhe publikimit të tyre në platformën e-prokurimit:

- **B54- Formulari Standard për Korrigjimin e Gabimeve në Njoftimet e Publikuara me datën 05.02.2024, që ka të bëjë me korrigjimin e kërkesave të përzgjedhjes**
- **B54- Formulari Standard për Korrigjimin e Gabimeve në Njoftimet e Publikuara me datën 15.02.2024, që ka të bëjë me shtyrjen e afatit të datës së hapjes se tendereve.**
- **Sqarimet shtes nga AK: 05.02.2024;**
- **Sqarimet shtes nga AK: 08.02.2024;**

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Me datën 07.04.2024 përmes platformës së e- Prokurimit kemi dërguar Kërkesën për Rishqyrtim të Autoriteti Kontraktues

Me datën 16.04.2024 përmes platformës së e- Prokurimit kemi pranuar përgjigjen/Vendimin nga Autoriteti Kontraktues që Kërkesën tone për Rishqyrtim.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Vlerësojmë se janë shkelur dispozitat ligjore që rregullojnë:

Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve, sipas nenit 59 të ligjit, ndërlidhur me nenin 40 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Kriteret për dhënie të kontratës, sipas nenit 60 të ligjit, ndërlidhur me nenin 27 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Dëshmitë e kërkesave, sipas nenit 64 të ligjit për prokurim publik.

Përzgjedhja e pjesëmarrësve dhe dhënia e kontratës, sipas nenit 56.1, paragrafi 1.2 të ligjit.

Parimet e përgjithshme të prokurimit:

Ekonomiciteti dhe Efikasiteti, sipas neni 6 të ligjit.

Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi, sipas neni 7 të ligjit.

që kanë të bëjnë me;
Kërkesat mbi gjendjen ekonomik financiare, sipas nenit 68 të ligjit dhe nenit 8.1 dhe 8.2 të FTD-së,
Aftësitë teknike dhe/ose profesionale sipas nenit 69 të ligjit dhe neni 9.1 dhe 9.2 të FTD-së,
Kërkesat e formale/administrative
Kriteret e dhënies së kontratës, sipas nenit 60 të ligjit dhe nenit 27 të Rregullores

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve, sipas nenit 59 të ligjit, ndërlidhur me nenin 40 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, lidhur me “Kërkesat mbi gjendjen ekonomik financiare” sipas nenit 68 të ligjit dhe nenit 8.1 dhe 8.2 të FTD-së.

Autoriteti kontraktues me datë 02.04.2024 ka ngarkuar në platformën e e-prokurimit “**B58 Njoftim mbi vendimin e autoritetit kontraktues**” së bashku me “**Letrat Standarde për tenderuesin e eliminuar dhe Suksesshëm**” ku ka njoftuar se shtatë (7) nga tete (8) ofertuesit janë shpallur të **papërgjegjshëm** dhe ka njoftuar se ka rekomanduar për dhënie të kontratës operatorin ekonomik **BM Group SHPK**.

Arsyet e eliminimit të grupit të operatorëve ekonomik sipas “Letrës Standarde për tenderuesin e eliminuar” janë të cilat konsiderojmë se janë nxjerrë me konstatim të gabuar dhe jo të drejte të gjendjes faktike, konstatime të cilat do të kundërshtojmë në tërësi.

ARSYEJA 1. -*“Nuk e keni plotësuar Kërkesën 2 të Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare - Garancioni i ofruar është me kushtëzim nëse e fiton projektin do të shqyrtohet përkrahja financiare deri në 4 mil, jo siç është kërkuar i pakushtëzuar”*

Gjendja faktike është se në dosjen e tenderit tek, Seksioni II, “Fleta e të dhënave të tenderit”, gjegjësisht “Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare” të nenit 8.1 & 8.2, ceket: **Kërkesa 2:**

“Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se ka kapital financiar për realizimin e kontratës, mjete të gatshme në bankë ose mbështetje bankare- qasje të pakushtëzuar në kredi për realizimin e kontratës në vlerë prej së paku 4 milion Euro (min. 60% të plotësohet nga

lideri ne rast te grupit).”

Dëshmia 2:

“Deklaratë nga banka që dëshmon se OE ka mjete të gatshme në xhirollogari ose gasje te pakushtëzuar në kredi për realizimin e kontratës në vlerë prej së paku 4 milion Euro (min. 60% te plotësohet nga lideri ne rast te grupit).

Dokumenti të jetë origjinal i nënshkruar dhe vulosur nga institucioni Bankar (në rastin e kredisë se pakushtëzuar OE duhet të paraqes dokumentin nga banka në emër të projektit).”

FAKTET DHE ARGUMENTET tona lidhur më këtë “arsyetim”, mbështeten në PROVAT të cilat janë pjesë e ofertës së dorëzuar për këtë aktivitet të prokurimit, por që qëllimisht janë injoruar nga autoriteti kontraktues gjatë fazës së vlerësimit të tenderëve dhe fazës së shqyrtimit të kërkesës tonë për ri-shqyrtim.

Konsiderojmë se “konstatimi” i autoriteti kontraktues se neve si grup i operatorëve ekonomik nuk kemi përmbushur kërkesën e mësipërme (neni 8.1&8.2, kërkesa 2) me arsyetimin se kinse garancioni i ofruar nga banka është me kushtëzimin **“nëse e fiton projektin”**, është i qëllimshëm dhe jo në përputhje me TËRËSINË e përmbajtjes së kërkesës së cituar më lartë, por e bërë në mënyrë selektive vetëm në një parafrzim të dobët të autoritetit bankar, i cili edhe po të shikohej në kuptimin e tërësishme nga ana e autoritetit kontraktues, do vërtetohej se banka ka ofruar QASJE në kredi për **“ngjarje të ardhshme, e cila pritet të ndodhë”**, sepse edhe kërkesa e mësipërme i referohet një ngjarje te ardhme dhe është specifikuar QASJE (logjika dhe ligji thotë se jo te gjitha kompanitë kane mundur ta fitojnë një kontrate, por vetëm njeri nga ata).

Andaj, dëshmojmë se; Garancioni i ofruar sipas Letër Referencës, shihet qartazi se i njëjti përmbush **të gjitha** kriteret e kërkuara nga autoriteti kontraktues dhe **nuk është i kushtëzuar**, për arsyet se Procredit Bank, citojmë: *“OE Ada Consulting Group SHPK është duke zhvillu biznes me bankën dhe përdor produkte te ndryshme si depozita ne para të gatshme, transfere e tërheqje kombëtare e ndërkombëtare të parave, dhe produkte e shërbime tjera”.*

fakte këto që dëshmojnë se operatori ekonomik **është solvent** dhe ka para të gatshme në bankë.

Për me tepër konsiderojmë se autoriteti kontraktues ka dështuar që të vlerësoje drejtë gjendjen faktike, kur nuk ka marrë për bazë garancionin që Procredit Bank ka dhënë ne Letër Referencën me nr. prot. OT-02-2081, dt.06.02.2024, kur ka garantuar, citojmë: *“...klienti **nuk posedon limit** kreditor, rrjedhimisht Procredit Bank do të konsideroj përkrahjen financiare deri në **4,000,000.00 EURO**, pas analizës të bërë nga analistët tanë të kredive”*,

Pra, narracioni i ndërtuar nga autoriteti kontraktues se garancioni i ofruar është i kushtëzuar, është **i padrejtë**, pasi që kur konstaton se kinse garancioni i ofruar nga banka është me kushtëzim **“nëse e fiton projektin do të shqyrtohet përkrahja”**, këtë konstatim e rrëzon në tërësi pjesa e dytë e fjalisë në pasuesin 2 të Letër Referencës, e cila tregon në mënyrë të qartë se Ada Consulting Group SHPK **“...nuk ka limit kreditor..”**.

Theksojmë se autoriteti kontraktues ka përdorur standarde të dyfishta gjatë vlerësimit të vlerësimit të tenderëve lidhur me trajtimin e Kërkesës 2 të përshkruar tek neni 8.1 & 8.2 të FTD-se, sa i përket pranimit si të vlefshëm të Garancionit të operatorit ekonomik të shpallur fitues “BM Group SHPK”, ndërsa atë të dorëzuar nga kompania jone, jo. Autoriteti kontraktues ka konstatuar se garancioni i ofruar nga “BM Group SHPK” i përmbush kushtin për të qenë i pakushtëzuar, edhe përkundër se gjuha e përdorur në letër referencën e shkruar për operatorin e rekomanduar për kontratë është në kuptimin e njëjtë, respektivisht kur Banka ka theksuar se, citojmë: **“... bazuar në politikat e matjes dhe menaxhimit të riskut lidhur me mbështetjen financiare...”**, Andaj në kuptimin e shprehjes konsiderojmë se shprehja ka kuptimin e njëjtë sikurse edhe tek garancioni ynë bankar, kur thuhet se: **“pas analizës të bërë nga analistët tanë të kredive”**.

Kjo ndodhe sepse të gjitha banka nuk japin kredi apriori pa bërë analize të riskut, që behet nga analistët e kredive brenda secilës banke. Andaj, Banka e operatorit të rekomanduar për kontratë ka theksuar se, citoj: **“Dëshirojmë t’ju informojmë se Banka merr në konsideratë...”**, konsiderojmë se kjo shprehje ka kuptimin e njëjtë sikurse edhe tek garancioni ynë bankar, kur thuhet se: **“...rrjedhimisht Procredit Bank do të konsideroj”**.

Pra autoriteti kontraktues gjatë vlerësimit të çështjes së njëjtë, ka favorizuar operatorin ekonomik “BM Group SHPK”, në raport me ne si OE, duke përdorur standarde të dyfishta në trajtim, gjatë vlerësimit të kërkesave sipas nenit 68 të LPP-se dhe atyre të nenit 8.1 & 8.2 të FTD-se, me çfarë ka bërë shkelje të rëndë të nenit 7 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i cili ndërlidhet me, përcakton se:

“1. Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jodiskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente”

ARSYE 2. - “Nuk e keni plotësuar Kërkesën 2 mbi mundësinë teknike dhe/ose profesionale-Nuk ka dëshmuar punë të kryera për dyer X-ray Automatike. Lidhur me punimet me X-ray të Klinika e Ortopedisë, për këtë projekt mungon pranimi teknik” .

Sipas kerkese se përcaktuar tek, Seksioni II, “Fleta e të dhënave të tenderit”, gjegjësisht “Kërkesat mbi mundësitë teknikedhe/ose profesionale” të nenit 9.1 & 9.2, ceket:

Kerkesa 2:

“Operatori ekonomik duhet të dëshmoj se ka realizuar me sukses projekte te ngjashme- ndërtim ose renovim i objekteve te larta, në vlerë të përgjithshme jo me pak se 25 Milion Euro, gjatë periudhës se shkuar tre vjeçare deri në Njoftimin për Kontratë. Ne rast te konsorciumit, së paku 50% e punëve te përfunduara kërkohet për liderin e grupit.

Së së paku në njërin projekt të jenë kryer punime lidhur me X-ray, Gaz medicinal, ventilim, klimatizim, dyer Xray Automatike, etj.”

Deshmi 2:

Një Listë të projekteve të realizuara - Original e vulosur dhe e nënshkruar.

Lista duhet t'i ketë këto te dhëna:

- Titulli I kontrates*
- Investitori*
- Të dhënat e personit kontaktues,*
- Datën e fillimit dhe te përfundimit të projektit,*
- Vlerën e projektit.*

Konsiderohen të vlefshme vetëm listat me të dhënat e lartcekura.

Për çdo projekt te realizuar kërkohet Referencë ose Procesverbal i Pranimit teknik (për investitor privat AK mund t'i verifikoj transaksionet financiare).

Pra Komisioni vlersues i tenderve kur ka “konstatuar” se z. Morina nuk e ka certifikatën siç është kërkuar, ka mohuar një vendim tërsisht ligjor, mbi bazën e të cilit i njëjti është certifikuar dhe ka marr kualifikimin **Ekspert per Sigurinë dhe Shendetin ne Punë**.

Gjithashtu konsiderojmë se arsyet kur autoriteti kontraktues ka bërë "eliminimin" mbi bazën e e mosplotësisimit të kërkesave të lartcekura, ai këtë e ka bërë ne kundërshtim te plotë me nenin 64 te LPP-se i cili percakton se:

*“ Një kandidat ose tenderues do të dëshmoj me certifikatë, **vërtetim apo dëshmi të tjera të mjaftueshme** të kërkuara në mënyrë të arsyeshme nga Autoriteti Kontraktues që: (i) arsyet për mos-kualifikim sipas nenit 65 të këtij ligji nuk zbatohen; (ii) të verifikojë përshtatshmërinë e tij profesionale, siç kërkohet nga Autoriteti Kontraktues sipas nenit 66 të këtij ligji; (iii) i plotësojnë kriteret e kërkuara nga Autoriteti Kontraktues sipas nenit 68-71 të këtij ligji.”*

Perfundimisht, duke u nisur nga faket dhe argumentimi i provave te cilat gjenden ne oferten/tenderin tone te dorezuar, propozojme Ekspertit Shqyrtues te Prokurimit dhe Panelit Shqyrtues te OSHP-se, qe te shpallin te jashtligjshme veprimet e autoriteti kontraktues ne lidhje me tarjtimin/vleresimin e ofertes sone, duke e konsideruar oferten/tenderin tone si te pergjegjshem

SHKELJET E AUTORITETIT KONTRAKTUES NE RAPORT ME OFERTEN E OPERATORIT EKONOMIK TE REKOMANDUAR PER KONTRATE “BM Group” SH.P.K.

Pas pranimit te njoftimit se autoriteti kontraktues ka ngarkuar “B58 Njoftim mbi vendimin e autoritetit kontraktues, me date 03.04.2024 bazuar ne dispozitat ligjore kemi paraqitur kerkese per qasje ne dokumentacionin e operatorit ekonomik te rekomnadar per dhenie te kontrates, ku nga autoriteti kontraktues na eshte ofruar nje e drejte e tille.

Pas vlerësimit të dosjes kemi gjetur se OE “BM Group” SHPK i shpallur fitues, as për së afërmi nuk i plotëson kushtet për tu shpallur fitues ne tenderin ne fjale, dhe i njëjti duhet te shpallet i papergjegjeshëm, dhe ate per arsyet ne vijim:

Arsyeja e parë:

Sipas kerkeses se përcaktuar tek, Seksioni II, “Fleta e të dhënave të tenderit”, gjegjësisht “Kërkesat mbi mundësitë teknikedhe/ose profesionale” të nenit 9.1 & 9.2, ceket:

Kerkesa 3.

- a) *Operatori ekonomik duhet të dëshmoj se posedon me Staf Teknik min. 50 punëtor, prej tyre se paku 20 punëtor të certifikuar për ushtrimin e punëve profesionale në siguri dhe shëndet në punë.*

Dëshmia 3.

- a) *Lista e stafit min. 50 punëtor, me profilin teknik te punëtorit, -Kontratrat ose marrëveshjet e punës për këtë projekt.*
- *Certifikatat e trajnimit për siguri dhe shëndet në punë, për min. 20 punëtorë*
- FAKTET DHE ARGUMENTET** lidhur me kete kerkese dhe deshmite e dorezura nga operatori ekonomik i rekomanduar per kontrate (BM Group SHPK). Ky operator ka prezentuar nje liste me gjithsej 59 punëtorë, prej te cileve 12 nga ata, si: Bajram Kiqina, Tafil Kiqina, Sami Bilalli, Shenjestar Kastrati, Hasan Gashi, Shemsi Gllareva, Albert Hoti, Shpend Shala, Asdren Kelmendi, Islam Shala, Bleron Neziri, Florim Berisha, **nuk kane fare kontrate ose marrveshje pune per kete projekt.** Pra, BM Group SHPK nuk ka prezentuar kontrate te punese siç eshte kerkuar ne kerkese e larte cekur, ndërsa për punëtorin Ejub Bërbatovci, kontratën qe e kanë prezantuar, e njëjta nuk është e nënshkruar. Keto fakte mund te vertetohen duke verifikuar oferten/tenderin e tij dorzuar ne platformen e e-prokurimit tek aktiviteti i prokurimit respektiv.

Si rrejdhoje e ketyre mungesave, operatori ekonomik BM Group ShPK konsiderohet se

nuk ka plotesuar dorezuar deshmite lidhur me kete kerkese.

2. Arsyjeja e dytë:

Sipas kerkeses se përcaktuar tek, Seksioni II, “Fleta e të dhënave të tenderit”, gjegjësisht “Kërkesat mbi mundësitë teknikedhe/ose profesionale” të nenit 9.1 & 9.2, ceket:

Kerkesa 3.

a) Ne kuadër të stafit teknik, duhet te jetë se paku nga një udhëheqës për pozicionet kryesore të punimeve, të cilët duhen të jenë teknik të diplomuar në shkolla të mesme dhe me përvojë së paku dy vite pas diplomimit

- 1 Ndërtimtar*
- 1 Elektracist*
- 1 Hidroteknik*
- 1 Suvatues-Fasader*
- 1 Murator*
- 1 Hidroizolues*
- 1 Instalues i ngrohjes qëndrore*
- 1 Instalues gazi*
- 1 Saldues i metalit*
- 1 Bojagji-Moler*
- 1 Montator i dyerve dhe dritareve*
- 1 IT (teknologji informacioni)*

Deshmi 3.

b)- Për 12 udhëheqësit b) kërkohen të Noterizuara Kontratat ose marrëveshjet e punës për këtë projekt dhe diplomat e shkollës se mesme teknike ose certifikata profesionale të dhënë nga institucionet e akredituara nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve.

Shenim: Deshmite e kesaj kerkese jane modifikuar perms pyetje pergjigjeve, dhe perms korrigjimit te njoftimit per kontrate te dates 08.01.2024.

FAKTET DHE ARGUMENTET lidhur me kerkesen dhe deshmite e dorezura nga operatori ekonomik i rekomanduar per kontrate (BM Group SHPK) ndaj kesaj kerkese (Kerkesa 3,b) jane se; “BM Group SHPK” nuk ka plotesuar as keto. Siç mund te shihet ne FDT dhe ne sqarimet e dates 05.02.2024 kerkesat kane qene specifike per teknike me diploma te shkolles se mesme ose certifikat nga ndonje institucion i akredituar nga Autoriteti Kombetare i Kualifikimeve dhe jo Bachelor, perderisa operatori ekonomik i rekomaduar per kontrate ka ofertuar me personat ne vijim qe nuk jane me kualifikime sipas kerkeses:

1. Avdyl Morina, i prezentuar si elektrikist - nuk ka diplomë të shkollës së mesme si teknik, apo certifikatë nga ndonjë institucion i akredituar nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve. Në vend të saj OE BM Group SHPK, ka prezentuar diplomë bachelor në drejtimin Inxhinieri i Elektroteknikës, dhe anje certifikim siç është kërkuar në FDT.

2. Egon Hoti, i prezentuar si Instalues i gazit -nuk ka diplomë të shkollës së mesme si teknik, apo certifikatë nga ndonjë institucion i akredituar nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve. Në vend të saj OE BM Group SHPK, ka prezentuar diplomën bachelor në drejtimin Inxhinier i Mekanikës, dhe një certifikatë trajnimi e cila është lëshuar nga “Medic” dhe është vështirë të lexueshme, po ashtu edhe një certifikatë trajnimi të lëshuar nga “G-Samaras” S.A. për mbajtjen e një trajnimi me datat 20 dhe 21 Mars 2023, pra trajnim dy ditore dhe jo siç është kërkuar në FDT, diplomë e shkollës së mesme teknike, ose certifikatë nga institucionet e akredituara nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve.

3. Besart Gashi, i prezentuar si Instalues i Ngrohjes Qendrore-nuk ka diplomë të shkollës së mesme si teknik, apo certifikatë nga ndonjë institucion i akredituar nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve. Në vend të saj OE BM Group SHPK, ka prezentuar diplomën bachelor në drejtimin Inxhinier i Mekanikës dhe asgjë tjetër, pra nuk ka asnjë certifikim sipas kërkesave të FDT.

4. Isa Gashi, i prezentuar si hidroizolues-nuk ka diplomë të shkollës së mesme si teknik, apo certifikatë nga ndonjë institucion i akredituar nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve. Në vend të saj OE BM Group SHPK, ka prezentuar një certifikatë nga **Sika Serbia**, e lëshuar për kompanin **Izolimi N.P.** me të cilën thuhet se punëtori Isa Gashi ka mbajtur trajnimin teorik dhe praktik **nje ditore pra me 4 Prill 2017 në Beograd për përdorim të sika sarnafil**, dhe asgjë tjetër, asnjë certifikim, apo diplomë e shkollës së mesme sipas kërkesave të FDT.

5. Fetah Meleqi, prezentuar si Montator i Dyerve dhe Dritareve, ndërsa në kontratë është me pozitë Teknik i Ndërtimit. Për këto punëtoreshë BM Group SHPK ka prezentuar diplomë të shkollës së mesme si Teknik i Ndërtimit, por i njëjti nuk posedon certifikim apo diplomë sipas kërkesave të FDT, për të angazhuar si montator i dyerve dhe dritareve.

6. Sami Elezi, i prezentuar si Montator i Dyerve dhe Dritareve. Edhe për këto punëtoreshë OE BM Group SHPK, ka prezentuar certifikatë të lëshuar nga “**Aluminium**” për mbajtjen e trajnimit **nje ditore pra me 16.05.2023** për Instalim të dritareve, trajnim ky i cili nuk është në pajtueshmëri me kërkesat e FDT.

Si rrjedhojë e këtyre mungesave, operatori ekonomik BM Group SHPK konsiderohet se nuk ka plotësuar dorezuar deshmite lidhur me këtë kërkesë.

FAKTET DHE ARGUMENTET, është fakt i patjetersueshem se autoriteti kontraktues ka konstatuar gabimish gjendjen faktike lidhur me dëshmitë tona të dorezuara me tender lidhur me realizimin e punimeve për dyer X-Ray. Pasi që Ada Consulting Group SHPK, ka paraqitur PROVA të vërtetuara se për projektin që përfshin punë të realizuara për X-Ray, duke bashkëngjitur Kontratën e lidhur me OE ACG-së dhe AK QKUK, të dt.05.07.2019, Raportet e Pranimit për projektin e teresishem si dhe raportin e pranimit për punët specifike X-Ray, dt.05.02.2023, (te cilat gjenden në ofertën tonë) ku në mënyrë të qartë vërtetohet se objekt i kësaj kontrate ka qenë për “Mbindërtimi dhe zgjerimi i objektit ekzistues të bllokut operativ të Klinikës së Ortopedisë, e ku sipas Planit për Menaxhimin e Kontratës-PMK të dt.25.08.2019, të përgatitur nga Menaxherja e Projektit QKUK, palët ishin pajtuar që, citoj: *“1. Duke u bazuar në kërkesën e AK (përfituesit-Klinika e Ortopedisë) punimet do të behen fillimisht në Objektin e ri-Klinika e ortopedisë, i cili objekt do të përfundohet në tërësi do të behet pranimit teknik i objektit të ri-klinika e ortopedisë, bartja e stafit nga objekti ekzistues i sallave të operacioneve si dhe funksionalizimi në tërësi. 2. Pas pranimit teknik të pjesëshem të objektit të ri-Klinika e ortopedisë, do të fillon rrenimi dhe punimi i objektit tjetër”*.

Pra kur autoriteti kontraktues ka konstatuar se, citoj: *“... për këtë projekt mungon pranimit teknik”*, ka dështuar që të vlerësojë se puna në këtë projekt ka qenë e organizuar në dy faza nga vetë autoriteti kontraktues, me qëllim të funksionimit të **Objektit të Ri-Klinika e Ortopedisë**, për cka në si kontraktor edhe e kemi bërë të mundshëm bazuar në PMK e dt.25.08.2019, dhe pikërisht për këtë arsye është konsideruar edhe pranimit i pjesëshem, ku në punët e kryera dhe të pranuar hynë edhe pozicionet e kërkuara sipas FTD-së.

Për sqarime objekti i përfunduar me këtë referencë është në funksion para datës së publikimit të këtij tenderi/aktiviteti të prokurimit dhe si i tillë është i pranuar dhe funksional, se përndryshe nuk mund të përdoret. Autoriteti kontraktues për të vërtetuar këto referencë thjesht ka mundur të parashtrijë kërkesë për sqarim sipas nenit 72 të LPP-se, dhe do kishim mundur të ofrojmë qasje të plote në dokumentet e komplet projektit, por një gjë të tillë mund ta kishin vërtetuar lehtë edhe vetë, meqë projekti është realizuar për një Institucion (QKUK) që është në vartësi të Ministrisë së Shëndetësisë.

Konsiderojmë se me këtë rast, Komisioni vlerësues nëse ka pasur me të vogël mëdyshje në atë se çfarë është “pranimit i pjesëshem”, atëherë është dashur dhe ka mundur fare lehtë që të kërkojë sqarime shtese, ashtu siç e obligojnë dispozitat e nenit 59 të LPP, në mënyrë që të bëjë vlerësim sa më profesional dhe në mënyrë që paqartësitë e mundshme të sqarohen. Andaj konsiderojmë se në këtë rast autoriteti kontraktues ka dështuar që të zbatojë dispozitat ligjore që i mundësojnë që të kërkojë qartësi, repektivisht nenin 59 par.2 të LPP.

ARSYEJA 3. - *“Nuk e kemi plotësuar Kërkesën 4 të Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale-Mungon Certifikata për ekspertin e sigurisë dhe shëndetit në punë, z. Ahmet Morina. E ka prezantuar një Vendim nga MFPT, por jo certifikatën siç është kërkuar”*.

Sipas kërkesës së përcaktuar tek, Seksioni II, “Fleta e të dhënave të tenderit”, gjegjësisht “Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale” të nenit 9.1 & 9.2, ceket:

Kerkesa 4.10

“Një ekspert i certifikuar për siguri dhe shëndet në punë”.

Deshmia 4.10

“Certifikata liçenca për ekspertin e sigurisë dhe shëndetit në punë”.

FAKTET DHE ARGUMENTET - Ada Consulting Group SHPK, me tenderin e tij ka dorezuar Vendimin me nr.ref":43011 dt.08.06.2023, të lëshuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, institucioni kompetent dhe pergjegjes me ligj për të lëshuar certifikata/vendime, me të cilin dëshmohet se z. Ahmet Morina është i certifikuar: **Ekspert për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë**, fakt që nuk mohohet as nga vet autoriteti kontraktues. Arsyeimi i përdorur nga autoriteti kontraktues për të na eliminuar nga tenderi është i zbehtë dhe i pabazuar, se, citoj: *“...por jo certifikatën siç është kërkuar”*, pasi që kualifikimi i një eksperti bëhet pas përfundimit të trajnimeve specifike dhe në momentin kur i aprovohet kërkesa për Certifikim nga organi kompetent (**Komisioni për Siguri dhe Shëndetin në Punë**) dhe jo nga kompani që organizojnë trajnime, në kuader të fushveprimit të biznesit të tyre.

Në rastin konkret autoriteti kontraktues ka dështuar që të vlerësoj drejtë lidhur me atë se kualifikimi i z. Ahmet Morina, është bërë në pajtim të plotë me nenin 4 paragrafi 5, si dhe nenin 12 par 1 të Rregullores Nr.01/2021 për Kualifikimin e Personave Përgjegjës për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, Licencimin e Kompanive të Shërbimeve dhe Trajnimeve për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, me të cilët përcaktohet se:

“ Neni 4 par 5: - Personi që posedon kualifikimin e ekspertit për sigurinë dhe shëndetin në punë, i lejohet: 5.1 Të punojë si i punësuar në çdo kompani” , “Neni 12 par.1: - Një kandidat që i ka plotësuar të gjitha kushtet dhe kriteret e përcaktuara në këtë Rregullore, certifikohet si ekspert për sigurinë dhe shëndetin në punë. Vendimi merret nga Komisioni për Siguri dhe Shëndetin në Punë”,

3. Arsyja e tretë:

Sipas kërkesës së përcaktuar tek, Seksioni II, “Fleta e të dhënave të tenderit”, gjegjësisht “Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale” të nenit 9.1 & 9.2, ceket:

Kerkesa 4.5.

- Një Inxhinier i Diplomuar i Ndërtimtarisë – Hidro, se paku 5 vite përvojë pune profesionale;

Dëshmitë 4.3 – 4.10:

- Diplomat e noterizuara (fakulteti sipas sistemit 5 vjeçar ose master),*
- CV e nënshkruara nga vetë inxhinierët,*
- Kontratat ose marrëveshje të punës për këtë projekt (të noterizuara),*
- Referencat për përvojën e punës sipas kërkesës,*

- Licenca me afat për gjeodetin ose kompaninë.

Ne rast se OE ka marrëveshje bashkëpunimi me kompani te licencuar për ofrimin shërbimeve të gjeodezisë, OE duhet të ofroj kopjen e marrëveshjes së bashkëpunimit për realizimin e këtij projekti.

- Certifikata licenca për ekspertin e sigurisë dhe shëndetit në punë.

FAKTET DHE ARGUMENTET lidhur me kete kerkese dhe deshmitë e dorezura nga operatori ekonomik i rekomanduar per kontrate (BM Group SHPK). “BM Group” SHPK, ne poziten e Inxhinierit te Diplomuar te Ndertimtarise –Hidro, ka prezentuar z.Muhadin Morina, CV e te cilit nuk eshte nenshkruar nga vet inxhinieri konform kerkeses se lartecekur, por eshte nenshkrua ne nje formë elektronike (duke perdorur programe si PDF, power point apo te ngjashme). Kjo mos perputhje e nenshkrimit qe eshte bere tek kontrata per angazhim te inxhinierit ne fjale dhe

nenshkrimit te vendosur ne CV, konisderojme se eshte e manipuluar, duke pas parasysh se s’kane ngjashmeri, shpresojme te jete i njejte/ngjashem me ate ne pasaporte ?!

Ne vendimin e kerkeses per rishqyrtim te dates 16.04.2024, autoriteti kontraktues thote: *“.... Nenshkrimi elektronik eshte i lejuar ne kete shekull....”* , duke ju shmangur shqetesimit/dyshimit tone te ngritur lidhur me nenshkrimin, ku neve nuk kemi kundërshtuar nenshkrimin elektronik por kemi kerkuar te respektohet kerkesa siç ka qene ne FDT pra te jete e nenshkruar nga vet inxhinieri.

Si rrejdhoje e ketyre mungesave, operatori ekonomik BM Group ShPK konsiderohet se nuk ka plotesuar dorezuar deshmitë lidhur me kete kerkese.

4. Arsyja e katërt:

Sipas kerkeses se përcaktuar tek, Seksioni II, “Fleta e të dhënave të tenderit”, gjegjësisht “Kërkesat mbi mundësitë teknikedhe/ose profesionale” të nenit 9.1 & 9.2, ceket

Kerkesa 4.10.

- Një ekspert i certifikuar për siguri dhe shëndet në punë

Dëshmitë 4.3 – 4.10:

- Diplomat e noterizuara (fakulteti sipas sistemit 5 vjeçar ose master),

- CV e nënshkruara nga vetë inxhinierët,

- Kontratat ose marrëveshje te punës për këtë projekt (te noterizuara),

- Referencat për përvojën e punës sipas kërkesës,

- Licenca me afat për gjeodetin ose kompaninë.

Ne rast se OE ka marrëveshje bashkëpunimi me kompani te licencuar për ofrimin e shërbimeve të gjeodezisë, OE duhet të ofroj kopjen e marrëveshjes së bashkëpunimit

për realizimin e këtij projekti.

- Certifikata liçenca për ekspertin e sigurisë dhe shëndetit në punë.

FAKTET DHE ARGUMENTET lidhur me këtë kërkesë dhe dëshmitë e dorëzuar nga operatori ekonomik i rekomanduar për kontrate (BM Group SHPK). “BM Group” SHPK, ne pozitën e Ekspert i Sigurisë, ka prezantuar z. Muhamet Hamiti, i cili posedon një certifikatë të lëshuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, e cila është lëshuar me date 17.05.2017, Por, duke pasur parasysh kornizën ligjore respektivisht nenin 12 par 3 të Rregullores Nr.01/2021 për Kualifikimin e Personave Përgjegjës për Sigurinë dhe Shëndetin ne Punë, Licencimin e Kompanive të Shërbimeve dhe Trajnimeve për Sigurinë dhe Shëndetin ne Punë, i cili përcakton se: **“3. Certifikata e Ekspertit vlen pesë (5) jet nga data e lëshimit.”**, rezulton se e njëjta **është e skaduar dhe jo valide**

Ne vendimin e kerkeses per rishqyrtim te dates 16.04.2024, autoriteti kontraktues thote **“...certifikata ne fjale eshte leshuar me 17.05.2017 nga Ministria e Punes dhe mireqenies Sociale dhe nuk ka date skadimi, andaj per ne eshte e pranueshme duke marre parasysh se eshte leshuar nga Istitucioni Shtetor i RK dhe eshte document i noterizuar”**. Por autoriteti kontraktues nuk e trajton njëjtë dhe barabartë sipas parimeve te prokurimit edhe vendimi për certifikim qe kemi prezantuar ne është lëshuar nga po i njëjti institucion dhe sipas rregullores për certifikim (rregullore e po këtij institucioni) certifikata është valide 5 vite.

Si rrjedhojë e këtyre mungesave, operatori ekonomik BM Group ShPK konsiderohet se nuk ka plotësuar dorëzuar dëshmitë lidhur me kete kërkesë dhe se autoriteti kontraktues ka perdorur parime te dyfishta ne raport me kerkesat e njejta ndaj operatoreve ekonomik te ndryshëm, duke vepruar ne kndershtim me nenin 7 te LLP-se.

5. Arsyja e pestë:

Sipas kriterit te përcaktuar tek, Seksioni II, “Fleta e të dhënave të tenderit”, gjegjësisht Neni 30.1 Kriteret e Dhënies, është cekur kriteri i dhënies mbi bazën e te cilit do vlerësohen dhe krahasohen tenderët e dorëzuar, citojmë;

“Tenderi i përgjegjshëm ekonomikisht më i favorshëm i përcaktuar sipas kriterit të peshës së nën-kritereve të përshkruara Aneksin 6

Shënim: Kërkohet nga OE qe gjate përgatitje se Formularit te tenderit ne platformën elektronike, te plotësojnë te gjitha nen-kriteret e TEMF: Çmimin dhe periudhën me të gjatë të Garancionit te puneve (min 2 vite).

Mosplotësimi i Formularit te tenderit si duhet do te shpije ne eliminim te ofertes.”

Përderisa autoriteti kontraktues përmes sqarimeve te datës 05.02.2024 ka bere një korigjim te gabimit te tyre tek përshkrimi i kriterëve te vlerësimit dhe atë si me poshtë ku

është kërkuar nga operatorët ekonomik që gjatë përgatitjes së ofertës së tyre të përmbahen sqarimit, ose ndryshe sipas nenit 30.1 të FTD-së oferta e tyre duhet refuzuar.

Përmes sqarimit shtesë është kërkuar që ofertuesit të japin Afatin e Garancionit të këtij projekti _____ vite nga data e pranimit teknik, respektivisht nga data e leshimit të Certifikatës së pranimit preliminar, neni 33 i Kushteve të Përgjithshme të kontratës.

Perderisa operatori ekonomik “BM Group SHPK”, ka ofruar dhe plotësuar deklaratën në mënyrë të gabuar, duke dhënë garancion 7 vite **nga data e fillimit të punëve**, e jo ashtu siç është kërkuar me FDT, siç mund të shihni me poshtë:

Te cilën e gjeni të bashkangjitur me dokumentet e ankesës

Aneksi 6. KRITERET PËR DHËNIEN E KONTRATËS²

Ne vendimin për rishqyrtim të kërkesës të cilin e kemi pranuar datë 16.04.2024 autoriteti kontraktues thotë: *“..... ketë pretendim e konsiderojmë si pjesërisht të bazuar.....”* **pra autoriteti kontraktues e pranon se afati i garancionit perkatsisht aneksi 6.1 nuk është plotësuar sipas kërkesës së autoritetit kontraktues**, me tutje vazhdon *“..... por të shtate ofertat tjera në këto aktivitet e kanë plotësuar në mënyrë të njëjta Aneksi 6.1, sipas shabllonit të Dosjes së tenderit, duke mos përfshirë sqarimet e dhene të dates 05.02.2024....”*, me këtë autoriteti kontraktues e pranon se për këtë situatë i vetmi operator ekonomik që ka plotësuar siç duhet këtë deklaratë është kompania jone. Nga provat e prezantuar shihet se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë nuk ka plotësuar këtë udhëzim shumë të rëndësishëm që lidhet drejtpërdrejt me vlerësimin dhe krahasimin të ofertave të operatoreve ekonomik. Kjo e bën të pamundur që oferta e operatorit ekonomik “BM Group” SHPK të mund të vlerësohet dhe krahasohet me ofertat tjera, përderisa nuk janë në baze të barabarta të krahasimit. Ajo çfarë është e çuditshme, është fakti se autoriteti kontraktues e quan “devijim të vogël” duke ju referuar nenit 59.4 kinse nuk ka diçka MATERIALE, madje e merr guximin të prek dhe ndërhyjë në ofertën e operatorit ekonomik “BM Group” SHPK, si me poshtë: të bashkangjitur

Por harron se pesha që i është dhënë këtij kriteri të vlerësimit “Garancioni i Punimeve”, prej 10%, konsiderohet të jetë rreth **2.25 Milion euro**, nëse i referohemi ndarjes proporcionale me vlerën e parashikuar të tenderit, që është 22,513,201.67 euro.

KY KORRIGJIM I OFERTES SË NGA ANA E AUTORITETIT KONTRAKTUES QË KA KAQ SHUMË NDRYSHIM MATERIAL ËSHTË PERTEJ CDO SHKELJE !!!

Andaj çdo tentim për arsyetim të këtij veprimi, besojmë se është i qëllimshëm dhe në mbrojtje të së keqes dhe jo ligjore.

5. Arsyeja e gjashtë:

Sipas kërkesës së përcaktuar tek, Seksioni II, “Fleta e të dhënave të tenderit”, gjegjësisht “Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale” të nenit 9.1 & 9.2, ceket:

Kerkesa 2:

“Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se ka realizuar me sukses projekte të ngjashme- ndërtim ose renovim i objekteve të larta, në vlerë të përgjithshme jo më pak se 25 Milion Euro, gjatë periudhës së shkuar tre vjeçare deri në Njoftimin për Kontratë. Në rast të konsorciumit, së paku 50% e punëve të përfunduara kërkohet për liderin e grupit.

Së së paku në njërin projekt të jenë kryer punime lidhur me X-ray, Gaz medicinal, ventilim, klimatizim, dyer Xray Automatike, etj.”

Deshmi 2:

Një Listë të projekteve të realizuara - Original e vulosur dhe e nënshkruar.

Lista duhet t'i ketë këto të dhëna:

- Titulli I kontrates*
- Investitori*
- Të dhënat e personit kontaktues,*
- Datën e fillimit dhe të përfundimit të projektit,*
- Vlerën e projektit.*

Konsiderohen të vlefshme vetëm listat me të dhënat e lartcekura.

Për çdo projekt të realizuar kërkohet Referencë ose Procesverbal i Pranimit teknik (për investitor privat AK mund t'i verifikoj transaksionet financiare).

FAKTET DHE ARGUMENTET lidhur me këto kërkesë dhe plotesimit të saj nga ana e operatorit ekonomik “BM Group SHPK”, verëhet se në listën e projekteve të prezentuar ka kontrata të cilat janë nënshkruar dhe kanë filluar ekzekutimin para afatit të kërkuar në FDT, neve po listojmë si në vijim;

- **Ndërtimi i Stadionit të qytetit të Gjilanit**, data e nënshkrimit është 08.01.2018, ndërsa përfundimi 08.07.2022, ndërkohë që në kontratën e nënshkruar mes paleve OE BM Group SHPK dhe AI Trade, tek **Neni 1 {Qëllimi i Marrveshjes}**, përcakohet se: *“Qëllimi i kësaj marrveshjeje për furnizim është furnizimi me materialet e nevojshme sipas paramesës (ANEKSI) e cila është pjesë perberese e*

kesaj marreveshje, per qellime te ndertimit te projektit me titull: “Ndertimi I stadionit te qytetit te Gjilanit”...

Ndersa ne referencen e leshuar me 08.07.2022 nga Bau Holding, theksohet se: “ OE BM Group SHPK, me sukses ka perfunduar pjeserisht ndertimin e stadionit te Gjilanit ..”, prandaj referenca nuk perputhet me kontratën, për arsye se kontrat e nënshkruar mes palëve është vetëm per furnizim me material, dhe jo për ndërtim, prandaj kjo reference apo kontratë bie ndesh me kerkesen e AK te cekur me lart.

Poashtu kontrata është nënshkruar ne vitin 2018, ndërsa kërkesa decidive e AK ka qenë te perfshihen kontrata me pak se 25 Milion Euro, gjatë periudhës se shkuar tre vjeçare deri në Njoftimin për Kontratë (njoftimi per kontrate eshte bere 03.01.2024).

Sipas informacioneve qe dihen nga te gjithë permes medajave per kete project eshte nderprer kontrate dhe projekti nuk ka perfunduar asnjehere madje as ne ditet e sotme.

Kontrata Faza e pare renovimi i stadiumit te qytetit te Gjakoves, është nënshkruar me date 02.04.2020, ku eshte cekur se projekti do te perfundoje per 36 muaj apo 3 vite andaj

- nuk mund te merret kompet vlere e projektit pasi qe kerkesa ka qene te oferohen kontrata ne vlere prej 25mil ne tri vitet e fundit rrjedhimisht per vitet 2021, 2022 dhe 2023.
- **Kontrata per Ndertimin e stadiumit te qytetit – Faza dyte Drenas (projekt tre vjeqar),** OE BM Group SHPK, ka prezentuar një reference e cila ka daten 11.01.2024 por nuk ka informacione se kur kane filluar punimet dhe kur kane perfunduar. Po ashtu ne kontraten e nënshkruar me 20.11.2018 tek Neni 3 {Çmimi} përcaktohet se: **“ Çmimi i pergjithshem i kontrates 1,750,491.64 € Projekt eshte tre vjeqar, faza e pare 2018, Faza e dyte 2019 & faza e tretë 2020.”** Prandaj kjo kontrate nuk mund te merret per bazi pasi qe nuk ploteson kushtin e kerkuar nga AK.
- Per kontraten numer 5 ne listen e prezentuar me titull: **Ekzekutimi i punëve dhe furnizimi ne parking ne Prishtine,** e nënshkruar me 09.09.2020 mes paleve OE BM Group SHPK, dhe Parking Center, tek neni 1 përcaktohet se: **“Objekt I kesaj kontrate eshte bashkepunimi afarist mes paleve perkatesisht kryerja e punimeve: ne Ekzekutimin e punimeve (furnizim dhe pune) ne Parking Prishtne”** ndersa referenca e prezentuar nuk permban madje as daten e leshimit te references, e lëre me te dhena se kur kane filluar punimet, apo kur kane perfudnua. Po ashtu nuk eshte e qarte sa nga vlere e kontrates ne total eshte furnizim me material, e sa punime dhe se këto punime a perfshijne ndertimin e objekteve te larta.
- Kontrata e e listuar ne list numer 17 me titullL **Ndertimi dhe furnizimi ne objektet ne lagjen Marigona Hill,** e nënshkruar me date 25.05.2020 nuk eshte

specifikuar sasia e furnizimit apo ndertimit ndersa AK nuk ka kerkuar asnje sqartim per kete edhe perkunder faktit se ne FDT eshte cekur se “Për çdo projekt te realizuar kërkohet Referencë ose Procesverbal i Pranimit teknik (për investitor privat AK mund t’i verifikoj transaksionet financiare)”

- Kontrata e e listuar ne list numer 19 me titull: **Punimet ne parkun industrial Miradi**, e nenshkuar me date 01.10.2021, e që në referencem e datës 15.02.2024, theksohet se: “....**Natyra e puneve te kontraktuara eshte ndertim i larte dhe punet e infrastruktures dhe faze tjera percjellese**”, pra nuk eshte specifikuar vlera monetare e furnizimit siç ceket ne kontrate, poashtu nuk eshte percaktuar vlera monetare e puneve te infrastruktures dhe vlera monetare e punimeve ne ndertim te larte. AK nuk ka kerkuar asnje sqartim per kete edhe perkunder faktit sre ne FDT eshte cekur se “Për çdo projekt te realizuar kërkohet Referencë ose Procesverbal i Pranimit teknik (për investitor privat AK mund t’i verifikoj transaksionet financiare)”.

Ka edhe shume kontrate te cilat permbajne furnizim, punime ne ndertim te ulet, jane nenshkuar para vitit 2021 dhe AK nuk ka kerkuar asnje sqarim sipas udhezimeve dhe

- kerkesave te vendosura ne FDT dhe te sqaruara permes dokumenteve qe ka derguar gjate procedures si sqarimet e dates 05.02.2024 dokumenti B54 I dates 08.01.2024.

Ne vendimin per rishqyrtim te kerkeses te dates 16.04.2024 AK thote: “**se OE I rekomanduar ka paraqitur list te projektee ne total prej 30,901,003.51 euro**” ashtu siç e kemi shtjelluar edhe me lart eshte kerkuar 25 milion kontrata te perfudnuara ne 3 vitet e fundit konkretisht vitin 2021, 2022 dhe 2023. Andaj kemi kerkuar se duhet te verifikohen se keto punime te prezentuara se; a kane perfunduar gjate viteve 2021, 2022 dhe 2023 dhe a i perkasin fushes se ndertimit te larte, duke perjashtur furnizimet dhe punimet e ndertimtarisë se ulet-rrugeve infrastrukturës, parqeve etj.

Te gjitha këto qe u thanë me lartë, janë fakte të cilat operatorin ekonomik “BM Group SHPK” e bëjnë të jetë **i papërgjegjshëm**, dhe se i njëjti është shpallur fitues në kundërshtim me kërkesat e vendosura ne dosjen e tenderit dhe njoftim për kontrate nga ana e autoritetit kontraktues. Nje vepri i tille nga ana e autoriteti kontraktues eshte ne kundërshtim me nenin 56 te ligjit, citati:

Neni 56- Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave

Të gjitha kontratat publike do të jepen, sipas procedurave të themeluara për një seleksionim të tillë, dhe përmes:

së pari, vlerësimit të tenderëve dhe kandidatëve sipas kërkesave të kualifikimit të specifikuar në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit sipas paragrafit 2. të nenit 51 të këtij ligji, dhe tenderëve sipas specifikimeve teknike të kërkuara në bazë të nenit 28 të këtij ligji;

1.2 së dyti, vlerësimi i tenderëve në përputhshmëri të kritereve të vendosura në nenin 60 të këtij ligji.

Përfundimisht një veprim i tillë i autoriteti kontraktues, duke rekomanduar për dhënie të kontratës një operator ekonomik të papërgjegjshëm, bie në kundërshtim me vet përcaktimin e këtij kriteri “tenderi ekonomikisht më i favorshëm”, citojmë nënin 60, paragrafi 1, pika 1.2:

Autoriteti kontraktues do t’ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar 1.2 tenderin ekonomikisht më të favorshëm në bazë të kriterëve dhe peshën që është specifikuar në dosjen e tenderit sipas nenit paragrafit 3. të nenit 52 të këtij ligji.

PERMBLEDHJE E SHKELJEVE

Duke u nisura nga sa është deklaruar me sipër në këtë dokument lidhur me shkeljet e bëra nga autoriteti kontraktues, me poshtë në pika të përmbledhura janë paraqitur këto shkelje:

Autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të nenit 59 të Ligjit dhe nenit 40 të rregullores, duke mos vlerësuar ofertat/tenderët e operatoreve ekonomik në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë.

Autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të nenit 64 të ligjit, si dokument mbizotëruës, ku vendos kufizime lidhur me dorëzimin e dëshmimeve që kanë të bëjnë me kërkesat e përzgjedhjes të vendosura në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontratë.

Autoriteti kontraktues ka rekomanduar për dhënie të kontratës një operator ekonomik i cili është i pa përgjegjshëm në raport me kërkesat e përzgjedhjes por edhe mos plotësim të duhur të formularit të tenderit/deklaratës sa i përket një kriteri të vlerësimit, që është “garancioni i punimeve”!

Autoriteti kontraktues nuk ju ka përmbajtur përshkrimin të nenit 56 sa i përket respektimit të hapave që çojnë tek dhënia e kontratës (shih me sipër përshkrimin e nenit).

Autoriteti kontraktues ka bërë shkelje flagrante kur nenit për vlerësim të tenderëve atë 59 “Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve”, kur ka vendos të përmirësoj ofertën e operatorit ekonomik të rekomanduar për dhënie të kontratës, duke ja ndërruar periudhën e garancionit sipas dëshirës kriterin e vlerësimit.

Autoriteti kontraktues kur ka arsyetuar gabimin e bërë nga shtatë (7) operatorët ekonomik të tjera (përveç neve), ka dëshmuar se operatori ekonomik i rekomanduar

për kontrate është i pa përgjegjshme, por ka marr barrën e arsytimit për veprimet e tyre, e qe janë tërësisht të hamendësuar.

Autoriteti kontraktues ka bere shkelje te parimeve te prokurimit, nenit 7 ne momentin kur nuk ka trajtuar te gjithë operatorët njësoj ne raport me kërkesat e dosjes se tenderit dhe njoftimin për kontrate. Respektivisht me rastin e shpalljes fitues operatorin ekonomik BM Group SHPK, ka favorizuar të njëjtin ne dëm të kompanisë si grup i operatoreve ekonomik me i lirë dhe me të gjitha kërkesat e plotësuar.

Autoritet kontraktues duke vepruar ne kundërshtim me te gjitha nenet e mësipërme, ka vepruar ne kundërshtim edhe me nenin 1 'Qëllim' të ligjit, kur ka rekomanduar për dhënie një operator me çmim edhe më të lartë.

Andaj, duke marr pe baze te gjitha faktet dhe argumentet e prezantuara me sipër, si dhe provat e disponueshme, ku disa janë bashkangjitur ne tekst te kësaj shkrese, deri te tjerat janë ne ofertën e operatoreve ekonomik dhe dokumentet e procedurës se prokurimit për këtë aktivitet te prokurimit, rekomandojmë qe Paneli Shqyrtues i OSHP-së te nxjerr:

VENDIM

Ankesa e Grup i Operatorëve Ekonomik te udhëhequr nga ADA CONSULTING GROUP SH.P.K. te konsiderohet e BAZUAR.

Te anulohet "Njoftim mbi Vendimin e AK.

Aktiviteti i prokurimit te kthehet ne ri-vlerësim

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Shkeljet e mësipërme pritet të shkaktojnë dëm material të fitimit të humbur dhe të cilat dëme do të precizohen pas mendimit dhe konstatimit të ekspertit financiar.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

***Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.